



RAPORTI VJETOR 2017



FIQ

Forumi për
Iniciativa Qytetare
Forum for
Civic Initiatives



Të dashur miq dhe bashkëpunëtorë të Fondacionit FIQ!



E përmbyllëm 2017 me shumë ngjarje të cilat na ndihmojnë përherë e më shumë të kuptojmë rëndësinë e jashtëzakonshme të përfshirjes dhe aktivizmit qytetarë në procesin shtetformues të Kosovës.

Kur flas për përfshirje, më vijnë ndërmend kategori të shoqërisë sonë të lëna në mëshirë të fatit, apo të donacioneve të huaja. Janë pikërisht brengat dhe problemet e grave, të mbijetuara të luftës dhe sfidat e tyre ekonomike, shëndetësore, e sociale që më shkaktojnë dhimbje dhe përgjegjësi individuale; janë preokupimet e të rinjve pothuajse krejt të izoluar (nëpër komuna të ndryshme) të cilët trainohen për të parandaluar ekstremizmin, e radikalizmin pa mundur të kenë një fushë sportive, apo të organizojnë një koncert rinor, apo të kenë një edukim cilësor, që i aftëson ata për punësim; është cilësia e ajrit, niveli i kontaminimit të ujit, niveli i agresivitetit dhe i politizimit të shoqërisë tonë që influencojnë negativisht në mirëqënien e qytetarëve në Kosovë.

E festuam 8 Marsin duke protestuar me gratë dhe vajzat e komunitetit të Hades para zyreve të Bankës Botërore për zhvendosje, punësim dhe kompensim të dinjitetshëm. Vazhduam takimet e bashkëbisedimet me afërsisht 500 qytetarë prej 10 komunave të vogla të Kosovës, qytetarë, komunarë, të rinj e të reja përfaqësues prej sektorit të biznesit vendor, nga ku u bindëm, se korrupsioni, menaxhimi i mbeturinave, nepotizmi politik, punësimi i të rinjve, mbrojtja e kategorive sociale, dhe liberalizimi i vizave ishin preokupimet më të ndjeshme të tyre.

Në kuadër të angazhimit tonë për zhvillim të qëndrueshëm, vazhduam të promovojmë energjinë e gjelbërt nëpërmjet programit tonë – “Plane biznesi të gjelbërta e innovative” duke argumentuar e avokuar kundër orientimit të gabuar të investimeve në energjinë e thëngjillit.

Të nderuar miq!

Shqetësimet e mia, kurrsesi nuk mbeten veç ankesa, sepse si të tilla, ato veç do ti shtoheshin numrit të shumtë të gjetjeve pa ofruar zgjidhje e ndryshim.

Në bashkëpunim me partnerë strategjik, donatorë e mbi të gjitha qytetarë arritëm të realizojmë një sërë aktiviteteve me rëndësi për të cilat i jam mirënjohëse kolegëve të FIQ-it, donatorëve tonë strategjik, si RBF, Charles Stuart Mott Foundation, EU, NED, dhe kryesisht qytetarëve të Kosovës për besimin dhe bashkëpunimin profesional me FIQ.

Dajana Berisha,
Drejtoresh Ekzekutive

Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ)

FIQ është fondacion me një traditë të gjatë të punës me komunitetin për të promovuar filantropinë për zhvillim të qëndrueshëm. FIQ beson se komunitetet lokale janë pikënisja më e mirë për zhvillimin e aktivizmit qytetar dhe për udhëheqjen e ndryshimeve drejt arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, drejtësisë sociale dhe përmirësimit të mjedisit për qytetarët dhe komunitetet.

FIQ u themelua në vitin 2000 nga një grup i vogël i pionierëve që panë nevojën për mobilizimin e qytetarëve në proceset vendimmarrëse pas luftës në Kosovë - 1998-1999. FIQ, që nga krijimi i saj, është shndërruar nga një organizatë që punon për sigurinë e komunitetit dhe aktivizmin qytetar në një fondacion kombëtar që punon në sektor që garantojnë të forcimin e qytetarisë aktive si Zhvillimi i Qëndrueshëm, Dhënia e Granteve, dhe promovimi i filantropisë për plotësimin e boshllëqeve ekonomike të shoqërisë kosovare.

Vizioni

“Vizioni ynë është të drejtojmë zhvillimin e komunitetit në Kosovë, duke punuar me qytetarët për të siguruar një qëndrueshmëri socio-ekonomike”

Misioni

“Fuqizimi i qytetarëve përmes filantropisë”



Vazhdon saga e Hades

Hade. Ky fshat i vogël me probleme tejte të mëdha. Turpi dhe mëkati mbi padrejtësitë që u janë bërë këtyre banorëve bie jo vetëm mbi institucionet vendore por edhe ato ndërkombëtare. Ndërkohë që qeveria bënë plane për ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re pranë shtëpive të tyre, Banorët e Hades nuk kanë të drejtë të ndërtojnë në tokat e tyre.

Nisën në mars me rrënimin selektiv të shtëpive. Ndonëse banorët protestuan dhe e kundërshtuan këtë rrënim, Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe përfaqësues të Komunës së Obiliqit, të shoqëruar nga Forcat e Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës, me ekskavatorë kanë bërë shembjen e themeleve të shtëpive në Hade të Vjetër. Banorët deklarojnë, se do të mbrojnë pronat e tyre private qofedhe me protesta të dhunshme, pasi që e konsiderojnë këtë aksion si shkelje e të drejtave të njeriut.



Një shkrim i hollësishëm, që përshkruan jetën e përditshme të banorëve të Obiliqit, Hades nën efektin e djegies së qymyrit, pluhurit, mungesës së rrymës, shërbimeve bazike, shpronësimit të dhunshëm!

Ndërkaq më 8 mars gratë dhe vajzat e fshatit Hade në bashkëpunim me Forumin për Iniciativa Qytetare - FIQ protestuan para përfaqësisë së Bankës Botërore në Kosovë ndaj dështimit të Institucioneve të Kosovës dhe Bankës Botërore për vite me radhë, për të realizuar një zhvendosje me dinjitet dhe me të gjitha standartet e hartuara prej vetë Bankës Botërore dhe të miratuara prej Qeverisë së Kosovës.



Përderisa Qeveria e Kosovës nuk po ofron një zgjidhje për banorët e fshatit Hade, të izoluar prej planeve për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re, llogariten rreth 7 mijë banorë që afektohen ekonomikisht prej procesit të zhvendosjes.

Forumi për Iniciativa Qytetare vazhdon të qëndrojë pranë banorëve të Hades duke kërkuar zgjidhjen për kompensim të të gjithë qytetarëve të dëmtuar nga procesi i zhvendosjes së dhunshme.

Përveç kësaj, investimi marramendës në tënjgjill nëpërmjet projekteve si Kosova e Re do të sjellë rritje enorme të çmimit të rrymës për familjet Kosovare, do të shkaktojë pasoja në shëndetin e popullsisë lokale, dhe padyshim do ta zvarrisë dhe më shumë integrimin e Kosovës në EU.

FIQ vazhdon të avokoj se qymyri nuk është zgjidhja e duhur.

Drejtorja ekzekutive e FIQ, Dajana Berisha në emër të KOSID ka shtjelluar arsyen pse Kosova duhet të promovojë dhe nxisë funksionalizimin e interkonjeksionit Shqipëri - Kosovë në sektorin e energjisë.



Foto nga rrënimi i shtëpive

Takimet me komunitet për të diskutuar për temën “Problemet që cenojnë mirëqenien e banorëve në Fshatrat dhe Qytezat e Kosovës”



Forumi për Iniciativa Qytetare – FIQ ka zhvilluar takime në 10 komuna të Kosovës për të nxjerr në pah problemet më prioritare me të cilat ballafaqohen banorët e komunave më të vogla të Kosovës. Takimet janë zhvilluar me përfaqësues të banorëve në: 1.Fushë Kosovë, 2. Istog, 3. Kaçanik, 4. Kamenicë, 5.Lipjan, 6. Malishevë, 7. Podujevë, 8. Shtimje, 9.Viti dhe 10. Vushtrri.

Një ndër gjetjet kryesore, ishte nevoja, që këta qytetarë kishin për takime të tilla, në të cilat ata kanë shprehur brengat dhe pakënaqësitë e tyre në raport me qeverisjen lokale dhe atë qendrore. FIQ ka prezantuar në një raport të gjeturat të cilat në të shumtën e rasteve lidhen me mungesë transparence nga ana e qeverisjes lokale për investime kapitale të cilat nuk sjellin punësim lokal, përmirësim të ambientit, apo infrastrukturës së komunës, përkundrazi kanë shkaktuar degradim të mëtejshëm të ambjentit si dhe krijim të deponive ilegale.

Ndërkaq, për secilën komunë qytetarët kanë theksuar si jetike mungesën e vendeve të punës , dhe projekteve zhvillimore, gjë e cila po inkurajon familjet e sidomos të rinjtë, që ta lëshojnë vendin duke lëvizur qoftë në kryeqytet apo edhe deri në shtetet evropiane nëpërmjet emigracionit ilegal.

Hapi i parë pas këtyre gjetjeve dhe këtij raporti do të jetë formimi i një koalicioni me organizatat lokale te shoqërisë civile me qytetarë, grupe joformale, këshilla fshatrash, nxënës të shkollave me të cilët FIQ-i bashkërisht do të përpiqet një listë me kërkesa për zgjidhje prej 10 komunave.

FIQ gjithmonë afër Rinisë

Duke e cilësuar rininë si të tashmen e vendit dhe duke e njohur nga afër potencialin që të rinjtë e Kosovës kanë, FIQ vazhdon të bashkëpunojë ngushtë me rininë për të sjellur ndryshime esenciale në shoqëri. Gjatë punës në komunitet, si synim kryesor është angazhimi maksimal dhe ofrimi i hapësirës për të rinjtë e vendit tonë. Ofrimi i mundësive për të shprehur ide dhe kontribute, dhe për të ndarë energjinë e mirë për projekte inovative e me ndikim.

Forumi për Iniciativa Qytetare beson në aktivizimin rinor si një prej vlerave të demokracisë dhe angazhohet në promovimin e këtyre ideve në gjithë Kosovën.

Kështu, projekti Ambasadorët e Rinj, ka ndihmuar të rinjtë që të implementojnë ide në të mirë të komunitetit. Bashkë me rininë, mbikqyrësit e tyre, grupet joformale dhe FIQ janë implementuar ide projektesh të vogla në të mirë të komunitetit. Projekti Ambasadorët e Rinj, ka diversitet në ide pasi pjesëmarrës kanë qenë të rinjtë nga komunat kryesore të Kosovës. Dke ofruar kështu gjithëpërfshirje dhe trajtimin të barabartë për të gjithë rininë që jeton në Kosovë.

FIQ ka krijuar kështu rrjetin e Ambasadorëve të Rinj, duke përfshirë këtu gjithsej 26 ambasadorë nga komuna të ndryshme të Kosovës. Ky rrjet ka realizuar kështu 26 projekte komunitare, duke i realizuar nevojat e qytetarëve të vendit. Projekti është zbatuar në dy faza, fillimisht në 4 pilot komuna: Prishtinë, Pejë, Mitrovicë e Jugut dhe Mitrovicë e Veriut, ku 16 ambasadorët e pare të përzgjedhur kanë identifikuar idetë më të mira të prezantuara nga grupet joformale të të rinjve dhe në bashkëpunim me FIQ i kanë përkrahur këta të rinj deri në jetësimin e ideve në projekte konkrete. FIQ ka planifikuar që të zgjerojë platformën Ambasadorët e Rinj edhe në komuna të tjera gjatë vitit 2017, dhe projekti është zgjeruar në Kaçanik dhe Viti.



Simpoziumi Ambasadorët e Rinj shënoi punën dhe suksesin e më shumë se 100 të rinjve të përfshirë në këtë projekt!

Në vijim lista e projekteve fituese për vitin 2016:

Projektet fituese nga Prishtina janë:

1. Berat Mavriqi - *"Jam2016"*
2. Emira Polloshka - *"Ngrita e Efiqences në Shkolla Fillore"*
3. Drilon Hyseni - *"Ta ndryshojme Prishtinën tonë"*
4. Liridona Morina - *" Prishtina Live Guide".*

Projektet fituese nga Mitrovica janë:

1. Besnik Hoti – *"Mos rri në këmbë – Ulu"*
2. Enis Berisha – *Shënjëzimi I zonavë të rrezikshme në lumin Ibër dhe Sitnicë*
3. Lindata Hasani – *Rregullimi I oborrit të shkollës*
4. Gazmend Ismajli – *Parkingu I bicikletave.*

Projektet fituese nga Peja janë:

1. Ariston Lipa – *"Të ndërtojmë për Kafshët"*
2. Fisnik Kurhasani – *Mbjellja e pemëve dekorative*

Projektet e realizura nga grupet joformale gjatë këtij viti në komunën e Kaçanikut dhe Vitisë në vitin 2017 janë si në vijim:

- 1.Kaçaniku me libra;
2. Projekti *"Gjithçka për librin;*
3. Ulëse për parkun e qytetit në Kaçanik;
4. Ulëse për stacionin e autobusëve në Kaçanik;
5. Ndriçimi i shkollës së mesme *"Skënderbeu"* në Kaçanik;
6. Minibiblioteka për libra në Pozheran të Vitisë;
7. Ulëse në stacionin e autobusëve në Viti;
8. Ulëse dhe shporta në fshatin Terstenik, Viti;
- 9.Shporta recikluese për shkollën fillore *"Dëshmorët e Vitisë";*
10. Lojëra për fëmijë në fshatin Sllatinë e Epërme

Filantropia për një mirëqenie më të gjerë

FIQ në 2017 ka vazhduar angazhimet për promovimin e filantropisë për zhvillim të qëndrueshëm si dhe koordinimin me partnerët qeveritar dhe joqeveritar për krijimin e legjislacionit mbështetës –për filantropinë. Në këtë drejtim Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit bashkë me Forumin për Iniciativë Qytetare /FIQ, organizuan “Konferencën Kombëtare për Filantropinë”. Ky aktiviteti ka si qëllim të shtjellojë rolin e filantropisë në rritjen e bashkëpunimit ndër-sektorial për qeverisje të mirë dhe të identifikojë qasjet inovative në adresimin e çështjeve të zhvillimit të qëndrueshëm të filantropisë në Republikën e Kosovës.

Në këtë konferencë ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës, partnerë e përfaqësues të FIQ-it përkrahës në këtë proces, përfaqësues të BE-së, përfaqësues biznesesh që e kanë ndihmuar dhe po e ndihmojnë zhvillimin e filantropisë në Kosovë, anëtarët e Këshillit për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile dhe përfaqësues tjerë nga institucionet relevante nga shoqëria civile u tha se është qenësor aprovimi i legjislacionit për mbështetjen e kontributeve filantropike.



Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) mbajti ceremoninë për ndarjen e Çmimit FIDES për filantropinë në Kosovë, për vitin 2017

FIQ me këtë çmim shpreh mirënjohje për kompanitë dhe individët që kanë kontribuar për të mirën e përbashkët dhe beson se ky çmim do të shërbejë si inspirim për të tjerët, duke bërë që publikisht të kuptohet se si duhet të punohet për të mirën e komunitetit. FIQ nëpërmjet FIDES vlerëson humanizmin qytetar individual, vizionin e sektorit privat për t'i ardhur në ndihmë arsimit e inovacionit, dashamirësinë dhe mbështetjen e përhershme të diasporës, vullnetarizmin dhe energjinë e rinisë, si dhe liderët e mbrojtjes dhe fuqizimit të grave, dhe ata të mbrojtjes së mjedisit.

Këtë vit FIDES iu dedikua rinisë pasi që FIQ punon me të rinj në gjithë Kosovën, në krijimin e kapaciteteve të tyre për vendimarrje, si dhe për aktivizëm qytetar brenda komuniteteve në Kosovë.





Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, i ftuar special i FIDES 2017 i cili ndau edhe çmimin post-mortum për z. Robert Elsie tha se filantropia bashkëkohore shihet si një strategji për të paturuar kulturën e bamirësisë, dhe e falënderoi FIQ për punën për nxitjen e filantropisë, si një mekanizëm që avancoi bashkëpunimin ndërmjet tre sektorëve - publik, privat dhe atij civil - me qëllim mobilizimin e drejtë të komuniteteve për qëndrueshmëri dhe përgjegjësi sociale.

“Kështu krijohet ekosistemi i vlerave të cilat i mbart shoqëria Kosovare dhe për të cilat FIQ kujdeset për t’i promovuar duke sjellë më afër njerëzit, institucionet dhe sektorët e zhvillimit në Kosovë”, tha Haradinaj. Këtë çmim e pranoi Z. Artur Metani si mik, bashkëpunëtor profesionist i R. Elsie.

Çmimi FIDES për kontribut në nivel kombëtar “Hasan Prishtina” iu nda Raiffeisen Bank Kosovo për kontribut në projekte që avancojnë arsimin, inovacionin dhe kulturën. Çmimin e ndau drejtorja ekzekutive e FIQ Dajana Berisha .

“Që nga fillimi i operimeve tona ne kemi mbështetur projekte në arsim, kulturë, art, sport, mirëqenie sociale dhe do të vazhdojmë të punojmë në këtë drejtim në vitet që vinë”, tha Drejtori i Bankës Raiffeisen z. Robert Wright.



Çmimi FIDES për Ambient, iu nda ERA Group të cilët kanë bërë punë të mrekullueshme dhe atë në mënyrë të vazhdueshme në mbrojtje të mjedisit duke arsimuar edhe të rinjtë për mjedisin. Këtë çmim e ndau Jan Axel Voss zv. Ambasador i Gjermanisë në Kosovë.

“Diplomatët e sotëm duhet të marrin parasysh çështjet mjedisore, sepse ato mund të shkaktojnë problem politik. Nëse Kosova nuk kujdeset për mjedisin, do të ketë probleme në të ardhmen.

Të gjithë tanimë e dimë se ndotja e ajrit është problem serioz që si pasojë ka pasur humbje të jetëve njerëzore. Zbatimi i politikave në favor të mjedisit varet nga të gjitha institucionet e Kosovës, por edhe nga ne dhe qytetarët që e kemi obligim t’i edukojmë gjeneratat e reja për vlerën e mjedisit dhe pasurive natyrore të Kosovës”, tha ai.



Çmimi FIDES për kontribut nga Diaspora, iu nda Z. Fadil Berisha për përkrahje të pakusyer të komunitetit shqiptarë në Amerikë. Këtë çmim e ndau Dr. Lori E. Amy, Profesoreshë në Georgia Southern University, themeluese e OTTONomy e cila tha se diaspora është ajo që rindërton besimin, kujdesin dhe përgjegjësinë për të mirën e përbashkët.

“Ata përdorin të arriturat e tyre për të krijuar mundësi dhe për të ndërtuar të ardhme për vendlindjen. Dhe i tillë është edhe i nominuari Berisha i cili ja kushtoi jetën dhe veprën e vet promovimit të shqiptarëve jashtë vendlindjes. Liza Gashi, drejtore e Programeve në Germin, pranoi çmimin në emër të Berishës.

Çmimi FIDES për Fuqizimin e Gruas, iu nda znj. Kadire Tahiraj për kontribut të pashembullt në provimin e grave, mbrojtjen e të drejtave dhe fuqizimin ekonomik të tyre. Këtë çmim e dha Margarita Xhepa, Artiste e Popullit.

“Si grua, si artiste, si shqiptare është emocion i bukur të ndaj këtë çmim duke u nisur nga fakti se vet kam pas krenari të madhe për gratë shqiptare dhe traditën e tyre të punës. Zhvillimi i shoqërisë nuk ka si të përparojë pa qenë në krye grua apo nëna, figura kryesore në familje”, tha Xhepa.

Ndërkaq Kadire Tahiraj tha se mesazhi i Qendrës për Promovimin e të Drejtave të Grave në Drenas është që këto gra të pranohen në shoqëri dhe që nëpërmjet fuqizimit ekonomik atyre t’u hapet dera për të jetuar të lira e pa paragjykitime.





Çmimi FIDES për kontributin individual, iu nda z. Vezir Ramushi për kontribut ndaj kategorive më të rënda sociale, si familjeve me asistencë sociale dhe nevoja shëndetësore.

Këtë çmim e ndau Dr. Murat Jashari, përfaqësues i familjes Jashari i cili njëherazi përshëndeti nënat e gratë shqiptare për humbjen e sakrificën e tyre për të shtuar se filantropët kosovar si Nënë Tereza e Hasan Prishtina janë model me të cilët krenohet kombi e bota.

Çmimi FIDES për “Liderët e Rinj”, iu dha Grupit për Familjet në Nevojë për organizimin e pashoq vullnetar për kontribut ndaj familjeve, me theks të veçantë fëmijëve që vijnë nga familjet me asistencë sociale dhe probleme shëndetësore. Këtë çmim e ndau futbollisti i mirënjohur Lorik Cana.

“Këto shoqata, e fondacione me dëshirën e vep-
rimitarinë e tyre e vlerat që promovojnë mundohen
të jenë vlerë shtesë jo vetëm për veten por për të
gjithë njerëzit me të cilët punojnë, rriten apo bëjnë
biznes duke na mundësuar që në fund të fitojmë të
gjithë ne si shoqëri e si komb”, tha Cana.

Ndërkaq në emër të Grupit, Kaltrina Zeka tha se
është e nderuar me rezultatet e punës dhe atë që
ka arrit.



Në kuadër të muajit të filantropisë, Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) organizoi konferencën “Volunteers in Action”

Qëllimi i kësaj Konference ishte vetëdijësimi i të rinjve mbi rëndësinë e filantropisë dhe punës vullnetare. Duke pasqyruar rritjen e interesimit dhe dëshirës së të rinjve për t'u bërë pjesë e aktiviteteve të ndryshme vullnetare, me fokus në të mirën e komunitetit, FIQ ka vendosur të organizojë konferencën në fjalë ku organizatat e ndryshme ndanë përvojën e tyre për vullnetarizmin. Organizatat pjesëmarrëse në konferencë ishin: FIQ, UNICEF Innovations Lab Kosovo, Innovation Centre Kosova, Termokiss, Down Syndrome Kosova, XPortal ESports, Youth Council i Ambasadës së SHBA-ve si dhe Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sportit. Përfaqësues të organizatave pjesëmarrëse ndërkaq prezantuan mundësitë që ato ofrojnë për kultivimin e vullnetarizmit si dhe vlerësuan lartë kontributin e vullnetarëve në shtytjen përpara të së mirës së përbashkët. U diskutua për ndërlidhjen e punës vullnetare me inovacion, teknologji, ndërmarrësi dhe nisma të suksesshme në baza vullnetare.

Dajana Berisha, Drejtore Ekzekutive në FIQ, theksoi angazhimin maksimal që FIQ ka në promovimin e vullnetarizmit dhe filantropisë në punën e përditëshme, duke i inkurajuar kështu të rinjtë të jenë pjesë aktive e shoqërisë në vendimmarrje duke ndikuar kështu në krijimin e një shoqërie më të mirë. “Është në dorën tuaj, si gjeneratë e re të krijoni normat sociale të shoqërisë sonë. Në nivel shpirtëror vullnetarizmi ndërton parimet bazë të vendit. Në nivel ekonomik ofron mundësi për zhvillim dhe punësim. Vullnetarët promovojnë shërbime të cilat nuk arrin të mbulohen nga tregu i punës” theksoi Znj. Berisha.

Filantropia dhe Vullnetarizmi janë vlera bazike të FIQ. Një prej projekteve që është implemtuar ka pikërisht promovimin e vullnetarizmit “Young Ambassadors”. Gjithashtu një prej çmimeve FIDES 2017, do të ndahen për kontributet filantropike në nivel lokal, për liderët e rinjë. Duke e nderuar kështu punën dhe angazhimin që të rinjtë kanë në promovimin e të drejtave dhe vlerave të tyre në shoqëri.



Diskutim i Hapur: Filantropia për Ndërmarrësi

FIQ mbajti diskutimin e hapur “Filantropia për Ndërmarrësi” si pjesë e organizimit në kuadër të Javës Globale të Ndërmarrësisë në Kosovë 2017. Pjesëmarrës në panel ishin, Dajana Berisha, Drejtore Ekzekutive në FIQ dhe Besart Konushevci, themelues i platformës “Akademia”, ndër-marrësi sociale që synon parandalimin e plagjiaturës në punimet akademike, duke përfshirë kështu të dy konceptet bazë edhe të filantropisë edhe të zhvillimit të qëndrueshëm.



Pjesëmarrës në diskutim ishin të ri prej komunave të ndryshme të Kosovës. Duke pasur kështu rastin të njihen më përsëafëri me programin e filantropisë në FIQ, që vazhdon të jetë program bazik me vite. Duke ofruar shembuj të ndryshëm, Znj. Berisha sqaroi se si filantropia në kuptimin etimologjik të fjalës është investim afatgjat, që krahasuar me bamirësinë apo llojet e ndryshme të bamirësisë që zakonisht jemi mësuar t'i shohim në Kosovë. Kur bizneset kanë një qasje filantropiste, ndikojnë direct në zhvillimin e qëndrueshëm në vend. Shumë biznese sociale janë zhvilluar përmes programeve të granteve nga FIQ, duke përfshirë kështu komponentin filantropik në to. Duke promovuar kështu fokusin që bizneset duhet të kenë në përgjegjësinë sociale, dhe jo vetëm përfimin si profit personal.

Të gjitha këto u reflektuan në garën “Green Ideas” që FIQ e zhvillon çdo vit, duke i inkurajuar kështu qytetarët të aplikojnë në ide të ndryshme innovative dhe të gjelbërta. Vitin e kaluar tre prej fituesve ishin : “Our Roots” që përdornin mbetjet e kafës për të bërë këpurdha, Platforma “Akademia” si dhe DYVO një tjetër biznes social që përdor mbetjet e najlonit për të krijuar aksesore.

Prezentimi i platformës "Kosovo Ideas" tek Ambasadorët e rinj

Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) në bashkëpunim me Kosovaldeas zhvilloi një takim informues rreth platformës Kosovaldeas duke mbledhur rreth vetës ambasadorët e rinj që FIQ ka në komunat e ndryshme të Kosovës. Në takim morën pjesë përfaqësues nga organizata të cilat kanë zhvilluar fushata të suksesshme për ngritje të fondeve brenda platformës Kosovaldeas. Ndër to ishin "Termokiss", "Kino Lumbardhi" dhe "BoneVet".

Platforma KOSOVA ideas është platforma e parë e 'crowdfunding' e cila është 100% e përkushtuar në projekte të të gjitha fushave të artit dhe kulturës, angazhimit qytetar dhe qëndrueshmërisë, e realizuar në Kosovë dhe për Kosovën.

FIQ ka kohë që është partnere e Kosovaldeas nëpërmjet ofrimit të hapësirës për shfrytëzim për aktivitete të para-shikuara bashkarisht për përfituesit potencial nga kjo platformë.

Nëpërmjet këtij bashkëpunimi FIQ po punon që të rrjetëzoj përfituesit e projekteve të zhvilluara nga FIQ që të vazhdojnë aktivizmin e tyre dhe të shkëmbejnë përvoja me përfituesit e projekteve të paraqitura në Kosovaldeas.

Pas prezantimeve, të rinjtë kishin mundësinë të shkëmbejnë ide dhe sugjerime për të arritur një fushatë sa më efektive për idetë e tyre.



Kosova fiton në garën rajonale Green Ideas

Forumi për Iniciativa Qytetare, informon për fitorën e ideatorit Kosovar Besart Kunushevcit në garën rajonale për “Biznese të gjelbërta dhe Inovative” që u organizua në Kolasin, Mal të Zi prej 26-29 Korrik prej Balkan Green Foundation me mbështetjen e Rockefeller Brothers Fund. Platforma “Akademia”, e konceptuar dhe zhvilluar prej Besart Kunushevcit parasheh ndërtimin e një start up-i Teknologjik për Kosovë dhe vendet shqipfolëse të Rajonit, që do të ndalojë plagjiaturën në sistemin akademik të Kosovës duke mbështetur hulumtimet shkencore dhe duke zvogëluar mbeturinat nga përdorimi i letrës. Ky do të jetë aplikacioni i parë i këtij lloji në Ballkan që do të shërbejë si mjet për identifikim të plagjiaturës.


Platforma “Akademia” është përzgjedhur ndërmjet 18 ideve rajonale si një ndër projekt-propozimet më të mira, që sjell ndryshime konceptuale të sistemit akademik të Kosovës. Platforma do të mbështetet financiarisht prej me \$ 10.000 prej Rockefeller Brothers Fund dhe 2,500 euro prej FIQ.

Platforma “Akademia” u përzgjodh prej FIQ si njëra nga tre idetë më të mira në garën nacionale të organizuar prej FIQ “Ide Biznesi - Të Gjelbërta dhe Inovative 2017”.

Dy ide të tjera garuese në këtë garë ishin edhe “DYVO” e zhvilluar nga Nikki Murseli, dhe “Rrënjët tona” e ideuar prej Fisnik Kuqi. “DYVO” është një ndërmarrje sociale, që ka për qëllim dizajnimin e aksesorëve të përditshëm, nga ato trupore e deri tek ato shtëpiake, përmes ripërdorimit të mbetjeve të pleksiglasit, ndërsa “Rrënjët tona” është një ndërmarrje sociale, që ka për synim kultivimin e këpurdhave Oyster përmes reciklimit të kafesë.

FIQ e zhvillon garën “Plane biznesi – të gjelbërta dhe innovative” prej vitit 2012, me qëllim nxitjen e ndërmarrësisë sociale, ekonomisë së gjelbërt dhe punësimit lokal. Programi “Biznes plane – të gjelbërta dhe innovative” mbështetet prej Rockefeller Brothers Fund.





Dajana Berisha - Voice of America



Dajana Berisha mysafire në emisionin 06 LIVE - Video Dailymotion

Watch the video «Dajana Berisha mysafire në emisionin 06 LIVE» uploaded by Plus Television on Dailymotion.



Filantropia për zhvillim të qëndrueshëm

Filantropia përshkruan aktin e dhënies së kohës dhe gjërave për njerëzit në nevojë dhe komunitetin, pa pritur asgjë në rikthim. Është ajo dashuria ndaj njerëzve, që...

ZERI.INFO

DONATORËT 2017





Stafi:

Dajana Berisha
Drejtore Ekzekutive

Kushtrim Puka
Menaxher i Programeve

Sefë Govori
Menaxher i Financave

Arieta Dragusha
Zyrtare e Programit

Merita Mustafa
Zhvilluese E Programeve dhe Ngritjes së Fondeve

Vatra Qehaja
Zyrtare për Komunikim dhe Ngritje Fondesh

Lirika Hoxha
Zyrtare për Financa

Arlinda Azemi
Zyrtare e Programeve

Albesa Aliu
Zyrtare e Programit

Adelinë Nitaj
Asistente Ekzekutive

Merisa Abdullahu
Praktikante



FIQ

Forumi për
Iniciativa Qytetare
Forum for
Civic Initiatives

Adresa:

Lagja Pejton, Rr. Pashko Vasa, Nr.1,
10000 Prishtinë, Kosovë